

Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje

Filip (Tripko) Gojković

(14.02.1952, serb nga Fushë Kosova/Kosovo Polje, auto-vinçier, tre fëmijë)

Dragan (Mile) Vukmirović

(4.01.1958, serb nga Millosheva/Miloševo, komuna e Obiliqit/Obilić, teknik i makinerisë)

Zoran (Miroslav) Ađančić

(10.12.1968, serb nga Millosheva/Miloševo, vinçier, dy fëmijë,)

Filipi, Dragani dhe Zorani punonin në mi-hjen sipërfaqësore *Dobrosellë/Dobro selo*. Në mëngjesin e datës **22. 06. 1998**, u nisën në terren me veturën zyrtare të tipit *Uaz*, në drejtim të mihjes sipërfaqësore *Bardh i Madh/Belaćevac* për t'i marr rripat, va-jin dhe materialin tjetër të nevojshëm për punë, si dhe për t'i kryer edhe disa punë të tjera. Ata u nisën së bashku me dy kolegë shqiptar, Safedin Sylën dhe Femi Salihun. Kur arritën në **Graboc të Ulët/Donji Grabovac**, afër urës mbi lumin *Drenica*, i ndalën tre ushtarë të armatosur të UÇK-së. I kishin legjitimuar dhe bastisur. Më pas u urdhëruan dy shqiptarëve që të shkojnë, ndërsa Zoranin, Draganin dhe Filipin i morën me vete me veturën *Uaz*. Që nga ky çast, atyre u humbet çdo gjurmë. Fati i tyre nuk është i ndriçuar as sot. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Zoranit është i evidentuar me numër BLG-803504-01, ai i Filipit me numër YUK-050003-01, ndërsa ai Draganit me numrër YUK-050004-01.

Burimet: deklarata A.V, FDH-33858; deklarata N.N, FDH-5509; deklarata Z.Đ, FDH-5505; deklarata V.V, FDH-5506; deklarata V.J, FDH-664; deklarata S.S, FDH-17685; deklarata B.G, FDH-

5507; deklarata S.A, FDH-6152; deklarata D.A, FDH-6148; deklarata M.L, FDH-6151; deklarata D.S, FDH-6149; deklarata S.T, FDH-6153; deklarata J.A, FDH-6150; deklarata M.A, FDH-5508; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), transkript, 2.09.2002, 11/36, FDH-4940; AFP RRZHK e M, *Regjistri i të rrëmbyerve...*, FDH-17551; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; Sindikat radnika JP Elektrokosmet, *Stradanja...*, 18-20.

Dušan (Spira) Ađančić

(3.06.1942, serb nga Raskova/Raskovo, komuna e Obiliqit/Obilić, menaxher garazhe, katër fëmijë,)

Miroslav (Svetislav) Trifunović

(5.06.1955, serb nga Vushtrria/Vuçitër, vozitës)

Božidar (Miroslav) Lempić

(6.01.1959, serb nga Gojbujë/Gojbulë, komuna e Vushtrrisë/Vuçitër, jurist)

Mirko (Milan) Buha

(26.09.1963, serb nga Siboci/Sibovac, komuna e Obiliqit/Obilić, tre fëmijë, inxhinier reparti)

Pero (Velibor) Ađančić

(13.10.1970, serb nga Raskova/Raskovo, komuna e Obiliqit/Obilić, një fëmijë, ngasës ekskavatori)

Srboljub (Ljubiša) Savić

(19.06.1971, serb nga Gojbujë/Gojbulë, komuna e Vushtrrisë/Vuçitër, vozitës)

Si zakonisht, Pera Ađančić, edhe në datën **22.06.1998**, u nis në punë nga Raskova/Raskovo me makinën e vet të tipit *Jugo 55*, me targa të regjistrimit PR-874-57. Bashkë me te u nis edhe axha i tij Dušani. Mirko Buha ishte shef i punëtorisë elektrike në mihjen sipërfaqësore *Bardh i Madh/Bela-*